



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2019:276876

Datë: 28.10.2022

Numri i dokumentit: 03582178

P.nr. 127/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Sabaheta Kurteshi, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit Senida Nuri, në lëndën penale kundër të pandehurit **Z. R. nga fshati..., Komuna Dragash, me numër personal..., për shkak te veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II.nr.2543-11/19 , të datës 20.11.2019 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.09.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit Elfete Purova, të pandehurit **Z. R.**, të dëmtuarit **KEDS Prizren**, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.10.2022 përpiloi këtë:**

AKT GJYKIM

I pandehuri:

Z. R., i lindur më dt..., me numër personal..., i biri i Rr. R. dhe nënës Z. R., e gjinisë K., me vendbanim në fsh..., Komuna e Dragashit, i martuar, babai i 6 fëmijëve, penzioner, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Se prej datës së pa vërtetuar e deri me datë 14.12.220 , i pandehuri n ë shtëpinë e tije familjare e cila gjendët në fshatin..., Komuna e Dragashit, me qellim qe vetës ti sjellë pasuri të kundërligjshme, në atë mënyre që shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte, jashtë njehsorit elektrik, duke krijuar lidhje direkte jashtë matësit(para njehsorit) jashtë pikës matëse , ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me q ‘raste dëmtuarës KEDS--it i ka shkaktuar dëm material të konsiderueshëm ne shume prej 346,81 euro .

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 par.1) i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 2,4,7, 39,40,43,69,70,71,72 lidhur me nenin 314 par.1 të **Kodit Penal të Republikës se Kosovës, Kodi nr. 06/L-074** si dhe nenit. 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, te akuzuarit i shqiptohet :

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 250,00 (dyqindpesëdhjetë) €, të cilin dënim do ta paguaj përmes llogarisë rrjedhëse të kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, poçë se dënimin me gjobë i pandehuri nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti dënim me këtë Aktgjykim zëvendësohet me dënim me burgim dhe atë prej 13 (trembëdhjetë).ditëve burg, duke llogaritur 20,00 €, në një ditë burgu nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm .

E dëmtuara KEK-u, Distrikti ne Prizren, udhëzohet në kontest të rregullt civilë-juridik për realizimin e dëmit të shkaktuar.

OBLIGOHET i akuzuari që të i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato të bëhen në bazë të llogarisë dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 €, si dhe shumë prej 30 € në emër të kompensimit të viktimeve të krimit ,në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Prokurori i shtetit Elfete Purova në fjalën hyrëse, gjatë shqyrtimeve gjyqësore në fjalën e vet përfundimtare deklaron: duke u bazuar në rrjedhjen e shqyrtimit të sotëm ku janë administruar provat të propozuar si në aktakuzë dhe janë dëgjuar dëshmitarët – zyrtaret e KEDS-it dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe deklaratave të zyrtarëve në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në diapozitivin e aktakuzës. Pra është vërtetuar se me veprimet e të pandehurit janë formuar të gjithat elemente e veprës penale me të cilën akuzohet.

Andaj i propozoj gjykatës që për këtë veprë penale të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas Ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-Distrikti nga Prizreni – B. P. nga Prizreni në fjalën e vet përfundimtare deklaron: e mbështesim në tërësi fjalën përfundimtare e prokurorit të shtetit duke shtuar se gjendja faktike e përshkruar në procesverbalin e dt. 26.09.2019 është vërtetuar edhe sot përmes deklaratës këtu të pandehurit ku i njëjti thekson në mënyrë të qartë se energjia elektrike nuk ka shkuar nga shtëpia në lokal si dhe faktin kryesor se gjeneratorin e kanë ndaluar dhe pas shqyçjes së njehsorit të lokalit nga zyrtaret e KEDS-it ka qen e pa mundur që të ketë energjia elektrike përveç asaj që është konstatuar dhe në procesverbal lidhje direkte jashtë njehsorit. Gjithashtu shtojmë se fatura e kthimit të humbjeve është kalkuluar konform procedurës për identifikim dhe parandalim të shfrytëzimit të pa autorizum të energjisë elektrike të pranuar nga ZRJ në bazë të pajisjeve të cilët janë hasur ditën kritike të cilët pasqyrohen dhe përmes foto dokumentacionit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pra mbi bazat të lart cekura i propozojmë gjykatës që krahas dënimit meritore për veprën penale me qëllim të ekonomizimit të çështjes ta obligoj këtu të pandehurit që në emër të dëmit të shkaktuar të paguaj shumë prej 1.429,62 €.

I pandehuri Z. R. nga fsh. B. në fjalën e vet përfundimtare deklaron: mbetëm në tërësi pranë fjalës time mbrojtëse të dhënë sot në gjykatë dhe nuk e pranoj veprën penale me të cilën ngarkohem sepse nuk është e vërtetë që e kam shfrytëzuar rrymën në mënyrë direkte jashtë njehsorit elektrik por kabllin që e kanë has punëtorët e KEDS-it ka qenë prej gjeneratorit të shtëpisë ku është shfrytëzuar rryma prej gjeneratorit me rastin e ndaljes së rrymës nga KEDS-i. Ky gjenerator është përdorur për shtëpinë dhe për lokalin.

Fjala mbrojtëse e te akuzuarit :

I pandehuri Z. R. nga fsh..., në pyetjen e Prokurorit të shtetit pyet: a mundesh mu deklarua lidhur me dt. 26.09.2019 kur punëtorët e KEDS-it kanë ardhur në lokalin e juaj dhe kanë gjetur pa rregullsi çka keni me thënë?

I pandehuri është deklaruar atë ditë kanë qenë punëtorët e KEDS-it në fshat ku e kanë ndal rrymën për krejt fshatin dhe kur kanë ardhur në lokal punëtorët e KEDS-it e kanë gjetur agregatin e dhezuar dhe e kanë ndalë agregatin ku unë kam shkua në shtëpi dhe e kam lëshuar rrymën e atëherë punëtorët e KEDS-it e kanë gjetur rrymën e lëshuar në lokal. Unë kam agregatin në shtëpi ku është e lidhur rryma prej agregatit që është në shtëpi me lokalin përmes kabullit dhe atëherë kanë ardhur punëtorët e KEDS-it dhe e kanë gjetur këta punëtorë kanë shkruar dhe më kanë thënë që me nënshkrua procesverbalin e kam nënshkruar dhe nuk di çka kam nënshkruar. Kanë qenë tre punëtorët e KEDS-it.

P.SH. pyet: a është e vërtetë që ju nuk e keni lejuar punëtorët që të bëjnë shikimin dhe në katin e dytë?

I pandehuri: jo, kjo nuk është e vërtetë se ata kanë hyrë në katin e dytë se kati është i pa banueshëm.

P.SH. pyet: deri sa ti ke qenë jashtë lokalit a është e vërtetë që 3 pajisjet në lokal kanë qenë duke punuar dhe kur ke ardhur ti ato kanë pushuar së punuari meqenëse ti e ke ndal rrymën?

I pandehuri: është e vërtetë që kanë qenë 3 pajisjet mirëpo me gjeneratorin ka punuar dhe një pajisje dhe atë mulliri i kafes.

P.SH. pyet: ti ma nalt the se kur erdha unë në shtëpi e lëshova rrymën e ata kanë thënë se kur ka ardhur zaimi u ndalë rryma - cila është e vërtetë.

I pandehuri: unë e kam lëshuar rrymën sepse ka ardhur rryma në shtëpi mirëpo rryma është e lidhur prej shtëpisë dhe në lokal.

Në pyetjen e përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS-Distrikti nga Prizreni – B. P. nga Prizreni pyet: ju më herët e deklaruat se në fshatin tuaj kanë qenë duke u vendosur shtyllat elektrike dhe ka munguar energjia elektrike dhe pas ceremonisë së faljes në xhami ju deklaruat se keni shkruar direkt në shtëpi dhe keni bërë lëshimin e agregatit dhe pikërisht në ato momente zyrtarët e KEDS-it kanë arritur në lokal kurse më vonë e ndryshuat deklarin duke thënë se e kam ndaluar gjeneratorin dhe e kam lëshuar energjinë elektrike cila është e vërtetë.

I pandehuri: kur kam ardhur prej xhamie e kam ndal agregatin dhe e kam lëshuar rrymën lidhur me agregat është prej shtëpisë e me kabëll shkon te lokalit dhe po ka shkruar rryma sepse me agregat furnizohet vetëm aparati i kafes. Ka njehsor lokalit dhe aparati i kafes është i lidhur me kabull me gjeneratorin e shtëpisë dhe kur ndalet rryma ndezët gjeneratorin dhe punon aparati i kafes. Kur

kam shkua në lokal aty i kam gjet punëtorët e KEDS-it e lëshova rrymën në fakt ndërpresin dhe erdh rryma dhe me thanë se jemi duke bërë kontroll e ndalën rrymën dhe në ato momente nuk ka pas rrym në asnjë pajisje kanë ardh dhe në shtëpi dhe e kanë bërë kontroll.

Gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 242 par.5 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 09.02. 2022, në prezencën e prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarit. Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuarin në bazë të nenit 246 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzës, në bazë të nenit 246 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve 325 dhe 323 të KPPK-ës, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar por dhe në shqyrtime gjyqësor ka theksuar se nuk e ndien veten fajtor dhe nuk e pranon fajësinë.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale ndaj të pandehurit , ka administruar provat e propozuara sipas aktakuzës , provat të propozuara nga të pandehurit dhe atë: Lexohet përmbajtja e procesverbalit me nr. 2286016 të dt. 26.09.2019. Bëhet shikimi në foto dokumentacion dhe atë në 6 foto. Lexohet përmbajtja e faturës – kalkulimi i RH i dt. 30.09.2019, fatura nr. DPZHP1914715 e dt. 30.09.2019 si dhe në shkresë - kartelës të dt. 01.10.2019. si dhe leximi i përmbajtjes në transaksionit të konsumatorit të dt. 02.03.2022, dëgjimi i dëshmitarëve A. H. nga Prizreni dhe **A. M., nga Prizreni**

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht para se t'i vlerësojmë dëshmitë dhe provat tjera materiale është e nevojshme që të qartësohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme faktet në vijim:

Nga dëgjimi i dëshmitarit A. M. nga Prizreni gjykata ka vërtetuar së jeton në Prizren, është i punësuar pranë KEDS-it – të dëmtuarës, jo në gjini me të pandehurin, me të dëmtuarën - punëtor, numrin e ID kartelës....., **e i cili në pyetjen P.SH:** në lidhje me këtë rast ju keni qen pjesë e ekipës si kontroll te konsumatori në këtë rast i pandehuri Z. R. dhe keni faturua, një procesverbal qe mban numrin 228.... të dt. 26.09.2019, a ju kujtohet saktësisht çka keni gjetur dhe konstatuar tek konsumatori tani i pandehuri në këtë rast?

Dëshmitari ka deklaruar : atë ditë kemi qen kontrole në lokal ka qen një djalë dhe kemi kërkuar vendin e njehsorit elektrik se ku është për të kontrolluar ku pastaj kemi shkua te pika matëse – tek njehsorin elektrik. Kemi filluar me kontroll me lejen e atij djalit, kemi hequr bllobën distributive dhe kemi nxjerrë daljet dhe kemi nis kontrollin në lokal brenda ku kemi vërejtur pa rregullsi sepse kur nxirren daljet nuk duhet të pas rrymë në objekt, në ato momente në objekt ka pas rrymë jashtë matjes dhe kemi thirre pronarin me ardh i cili ka ardh dhe na u ka ndërprerë rryma në fakt lidhja qe ka pas jashtë matjes. Pronari nuk na ka lejua me verifikua se nga vjen ajo lidhje kemi dashtë me vërtetu në katin e dytë në objektin por nuk na është lejuar. Të gjitha këto i kemi shënuar në proces si dhe i kemi shënuar të gjitha pajisjet të cilat kanë qen në lidhje direkte, disa fotografit të bëra në vendin e ngjarjes, ato i kemi bërë pasi qe i kemi nxjerr daljet ku ka pas rrymë na i kemi bo foto si dëshmi për gjykatën për pajisje qe kanë qen të lidhura në mënyrë

direkte jashtë matjes, ka qen një djal i moshës madhore mbi 18 vjet dhe e ka thirr pronarin, kur ka ardh pronar pas një kohe ka qen i stresuar. Ne Lidhjen direkte e cila ka qen në këtë rasti nuk e kemi ndal rrymën sepse na kanë ndal rrymën dhe nuk kemi pas mundësi të shkojmë te vendi prej kujt e kanë marr edhe pse na ka thirr pronari për me shkua në shtëpi ku kemi shkua edhe në shtëpi na ke lejuar me bo kontroll dhe na ka treguar vendin se lidhjen e ka prej këtu në lokal mirëpo ne nuk kemi mund me besua se lidhjen e ka prej shtëpisë sepse ne kur kemi qen në lokal na kanë ndal rrymën dhe nuk na kanë lejua në lokalin qe të shkojnë në katin e dytë. Ne fillimisht i kemi kontrollua lokalin dhe pasi qe nuk e kemi gjet burimin dhe nuk na është lejuar qe të shkojmë në katin e dytë të lokalit për me verifikua se prej kujt është kjo lidhje direkt ne kemi shkua në shtëpi, kemi kontrolluar dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi. I pandehuri ne lokal nuk kam pa gjenerator por rrymë atë ditë ka pas, një kabull e kam pa qe ka dal prej shtëpisë deri te lokali , ka pas kablla vazhduese ku janë furnizua pajisjet qe i ka pas në lokal, ka qen ditë, kanë qen në korridor por nuk e di prej kujt kanë ardh për arsye neve na kanë prej burimin. Kablli ka kah ardh nuk e di dhe i njëjti është përfundua në lokal.insistimi për hyrje në katin e dytë gjithmonë ka qen për të munduar të verifikohet saktësisht kjo kabëll për të cilën nuk dihet kyçja kryesore.

Nga dëgjimi i dëshmitarit A. H. nga Prizreni, i lindur me dt. 24.05.1987, i punësuar pranë të dëmtuarës KEDS-it në Prizren në shërbimin e kontrollave dhe humbjen teknike, me të pandehurin jo në gjini, **Ku ne pyetjen e P.SH:** në lidhje më këtë rast ju keni qen pjesë e ekipës si kontroll te konsumatori në këtë rast i pandehuri Z. R. dhe keni faturue, një procesverbal qe mban numrin 228.... të dt. 26.09.2019, a ju kujtohet saktësisht çka keni gjetur dhe konstatuar tek konsumatori tani i pandehuri në këtë rast?

Dëshmitari ka deklaruar : po kemi qen në kontroll dhe është e vërtet se në momentin qe kemi shku në kontroll ka qen një punëtor aty dhe me lejen të tij kemi shku te njehsori elektrik, njehsori ka qen i pllombuar dhe pas shkyçjes së njehsorit elektrik ku në këtë rast punëtor tek njehsorit ka qen kolegu im paraprak kemi vërejtur se nuk është ndalur energjia elektrik në lokal. Ku pajisjet e shënuara në proces kanë pasur energjinë elektrike. Kemi kërkuar nga punëtori prezent që të thirre pronarin, ka kontaktuar dhe ne duke pritur pronarin për një moment tri pajisje qe kanë pas rrymë është ndalur dhe pasi janë ndalur prapë pas një kohë shumë të shkurt ka ardhur konsumatori në fjalë pa ofendime, kemi njoftuar për punën dhe pajisjet qe kanë pas rrymë dhe na ju ndalë rrymën. Konsumatori na tha se jeni të lirë me këqyrë, gjatë verifikimit me prezencë të konsumatorit kemi dal jashtë objektit por paraprakisht kemi vërejtur se nga jashtë ka një hyrje objekti për katin e dytë te lokali dhe atë prapa dhe kur unë personalisht kam dashur me hy te ajo hyrje konsumatori në fjalë më ka thënë “se nuk kie nevojë me hy aty” dhe aj ka kërkuar prej neve qe të shkojmë deri te shtëpia. Kur kemi shku në shtëpi kemi kontrolluar mirëpo në shtëpi nuk ka pas kurrfarë parregullsie dhe pasi kemi dal gjatë bisedës me konsumatorin kemi kërkuar për me leshu rrymën te lokali mirëpo na ka thënë se rrymën e merr prej shtëpisë për lokal dhe kolegu im ka thënë se nuk mundemi me gjete ku është ajo lidhje qe i furnizon këto tri pajisje sepse pajisjet tjera kanë qen në rregull. Konsumatori e ka thënë se pari se rryma vjen prej gjeneratorin e pastaj prej shtëpisë. Nuk më kujtohet a ka pas agregat dhe se zhurmë të agregatit nuk kam dëgjuar sepse në momentin kur nuk ka energjinë elektrike ne nuk kemi të drejt me punuar, e di se nuk na ka lëshuar rrymën, nuk e di arsyeje. Insistimi jon ka qen per ta verifikuar kabllin për tri pajisje pikërisht ka qen kjo arsyeja qe të shkojmë në katin e dytë dhe aty ka ekzistue dyshimi se kablli ka mund të vije prej katitë të dytë.

Nga kallëzimi penal i të dëmtuarës gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka keqpërdorur rrymën ku kjo u vërtetua ne kontrollin e bërë nga punëtorët – pran KEDS-it si anëtar të komisionit për kontroll të njehsorit ku gjendja e gjetur është përshkruar dhe protokollit i shqyrtimit elektrik -në procesverbalin e kontrollit nr. nr. 2286... të dt. 26.09.2019, shikimi në foto dokumentacion

në 5 kopje, ndërsa nga përmbajtja e procesverbalit me nr., gjykata vërteton se është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik si dhe është bërë regjistrimi i pajisjeve elektrike te konsumatori .

Me shikimin në përmbajtjen e faturës – kalkulimi i RH i dt. 30.09.2019, fatura nr. DPZHP1914715 e dt. 30.09.2019 si dhe në shkresë - kartelës të dt. 01.10.2019. si dhe leximi i përmbajtjes në transaksionit të konsumatorit të dt. 02.03.2022, gjykata vërteton se janë marrë të dhënat e njehsorit-procesverbal me rastin e kontrollit të njehsorit, ndërsa me leximin në faturën -përmbajtja e parashtresës kalkulimin ku vërtetohet se sa është shpenzuar rrymë si dhe vërteton se ka harxhuar konsumatori, kalkulimi dhe sa ka pësuar dëm këtu e dëmtuara KEDS-i distrikti në Prizren dhe sa është rikthimi i humbjeve . Nga shikimi në foto dokumentacion dhe atë në 6 kopje të afruar nga pala e dëmtuar gjykata vërteton gjendjen e gjetur në vende ngjarje.

Gjykata ka dal dhe ne vendngjarjeje ku konstatuar gjendjen faktike ne lokal ku nder tjera ka vërejtur : se është një kabull ku ka hyrje dhe dalje nga Lokali, ne lokal ka pas tavolina pune , karrige , një friz ,një vitrinë si dhe nj; aparat i kafes me mullirin. Pajisjet kanë qenë të kyçura në rrymë . Në kuzhinë të lokalit ka enë i vendosur kabulli zgjatës i rrymës i cili prej kthesës që shërben si kuzhinë përmes murit ka një dalje mbi dritare e që ka qasje jashtë objektit-lokalit e që ky kabull-tel rryme vazhdon deri tek shtëpia e të pandehurit të kuzhina verore. Me kyqjen e telit të rrymës në kuzhinë verore dhe pastaj me kyqjen e aparatit dhe mullirit të kafes nga ana e punëtorëve të KEDS-it u konstatua se ka rrymë edhe pse njehsori i lokalit ka qenë i ndalur nga punëtorët e KEDS-it . Sa I për ketë dy pajisjeve tjera të njëjtat nuk kanë pasë rrymë .Afër njehsorit në kthinë –kuzhinën e lokalit janë dy gjenerator që nuk janë të kyqur dhe nuk kanë sistem automatik të ndezjes .

Vlerësimi i mbrojtjes të akuzuarit

Mbrojtjen e të akuzuarit gjykata nuk e pranoi si të bazuar sa i për ketë faktit se nuk e ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, me kabulli direkt , sepse përveç provave të paraqitura nga akuza gjykata e ka vërtetuar dhe në bazë të daljes në vendngjarje te lokali i të pandehurit ku ka vërejtura dhe ka konstatuar si n më lartë , ashtu që mbrojtja e të akuzuarit është dhënë me qellim qe ti ikë përgjegjësisë dhe ndëshkimit sepse është e pa pranueshme qe të pranohet se i njëjti e ka shfrytëzuar energjinë elektrike nga shtëpia . **Gjithashtu këtu i akuzuari me asnjë provë nuk arriti të vërtetoj të kundërtën me paraqitje të do një fakti apo prove.**

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Gjykata nga provat e administruara si më lartë e posaçërisht dëshmime të dëshmitarëve e të cilave deklarata ju ka falë besimin e posaçërisht deklaratave te punëtorëve te KEDSIT te punësuar pran KEDSIT ne Prizren , daljes së gjykatës në vende ngjarje , me vëmendje te përkushtuar kjo gjykatë vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e te akuzuarit provohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale , nga neni 314 par.1 të KPRK-ës, andaj gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor duk i shqiptuar dënimin me gjobë dhe duke e gjykuar me e këtë duke u bazuar në Ligje, e më par në tërësi duke vërtetuar përgjegjësin penale juridike të akuzuarit .

Baza Ligjore

Gjykata gjatë marrjes se vendimit mbi dënimit ndaj të akuzuarit ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69,70,71,72 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjidhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se në gjykatë i akuzuari ka pas qëndrim të jetë korrekt, rrethanat ne te cilat është kryer vepra penale,

është familjar, andaj gjykata duke i marr parasysh këto ka ardhur në përfundim se me këtë lloji të dënimit është e bindur se edhe me dënim me gjobë do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 43 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës se është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedonte i akuzuari e që në të ardhmen i pandehuri edhe me kërcënim të dënimit nuk do të kryej veprë të re penale dhe në të ardhmen do të këtë kujdes , ndërsa si rrethanë rënduese Gjkata ka marrë parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer nga i akuzuari, si dhe natyrën e demit të shkaktuar tekë e dëmtuara KEDS- distrikti ne Prizren.

Vendimin ku udhëzohet e dëmtuara për realizimin e kërkesës pronësore juridike, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 463 Kodit të Procedurës Penale të Kosovës .

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u murrën në kuptim të nenit . 450 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Vendimin mbi shpenzimet në emër të taksës për kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 30,00 € (tridhjetë euro) , u mur në bazë të dispozitave te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Me sa u tha më lartë Gjkata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi e konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2019:276876, 22.09.2022

G j y q t a r i

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.